



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 565 Prot.

Roskovec, më 30.01 2023

V E N D I M

Nr. 7, datë 27/01 /2023

**“ PËR AUTORIZIMIN E KRYETARIT TË BASHKISË PËR KONKURIM NË PROJEKTET ME
DONATORËT”**

Në mbështetje të ligjit 139/2015 “Per vetëqeverisjen vendore“, neni 9 , pika 1.2 germa b , neni 23 dhe neni 54 pika dh , te ligjit 68/2017 “Per financat e veteqeverisjen vendore“ neni 45 , të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne RSH” i ndryshuar neni 44 , paragrafi II , germa a , të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomis nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, vendimit të Këshillit të Bashkisë , te VKB nr.98 date 23.12.2022 “Per miratimin e buxhetit , numrin maksimal te punonjesve te Bashkise Roskovec dhe ndermarjeve vartese si dhe nivelin maksimal te pagave per vitin 2023” si dhe materialeve te sjelle nga Drejtorite e Sherbimit Social dhe Projekteve te Bashkise;Këshilli i Bashkisë,

V E N D O S I :

- I. Miratimin e fondit me bashkefinancim nga B.Roskovec dhe UNDP per konkurim per projektin: “Askush të mos Mbetet Pase” (LNB2), me vlere totale 3,333,333 leke , nga e cila financim i UNDP ne shumen 3,000,000 leke dhe financimi i B.Roskovec ne shumen 333,333 leke.
Fondi prej 333,333 leke financim i bashkise per objektin e mesiperme, te perballohet nga fondi I miratuar ne buxhetun e vitit 2023 ne zerin “Kontribute per projekt. me bashkfinanc. me donatore”.
Duke bere dhe ndryshimet ne buxhetin e vitit 2023 nqs do shpallemi fitues.
- II. Miratimin e fondit me bashkefinancim nga B.Roskovec dhe Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale në kuadër të thirrjes për njësitë e vetqeverisjes vendore që do të mbështeten nga Fondi Social 2023: “Te kafja e gjyshit”, ku bashkefinancimi :
 - Për vitin 2023 bashkefinancimi nga bashkia do të jetë: 1,544,700, lekë , ose 40% te projektit ne total.

- Për vitin 2024 bashkëfinancimi nga bashkia do të jetë: 2,703,225 ,lekë, ose 70% te projektit ne total.

Fondi perkates sipas viteve per financim te bashkise per projektin e mesiperm, do te perballohet nga fondi i miratuar ne buxhetin e vitit 2023 ne zerin “Kontribute per projekt. me bashkfinanc. me donatore”.

Duke bere dhe ndryshimet ne buxhetin e vitit 2023 nqs do shpallemi fitues.

III. Ngarkohet Administrata e bashkise dhe Drejtoria Ekonomike per zbatimin e ketij vendimi.

IV.Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes.

KRYETAR
Kadri Hyska

